



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

**Raport për Auditimin Tematik të ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar në vitin 2023”**

**RAPORT AUDITIMI TEMATIK**

**“PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË, NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MJEDISIT, EVADUAR NË VITIN 2023”**

**Tiranë, Prill 2025**



## PËRMBAJTJA

<b><u>I. PËRMBLEDHJE</u></b> .....	<b>3</b>
<b><u>I/1. Hyrje</u></b> .....	3
<b><u>I/2. Objekti i Auditimit</u></b> .....	3
<b><u>I/3. Qëllimi i Auditimit</u></b> .....	3
<b><u>I/4. Metodologjia e Auditimit</u></b> .....	3
<b><u>I/5. Konkluzioni</u></b> .....	4
<b><u>II. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MJEDISIT</u></b> .....	<b>4</b>
<b><u>III. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:</u></b> .....	<b>19</b>

## **I. PËRMBLEDHJE**

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1476 Prot., datë 12.12.2024, “Mbi Auditimin Tematik me objekt “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë të ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit evaduar në vitin 2023”, në ambientet e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, më datë 17.01.2025 u mbajt Akt verifikimi nga audituesit e autorizuar të KLSH-së A. M, Xh. K dhe Sh. H.

### **I/1. Hyrje**

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me datë 28.12.2023 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin e Përputhshmërisë” të ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, sipas Programit të Auditimit nr. 562/1 prot., datë 30.06.2023, mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afatet dhe nivelin e zbatueshmërisë, koherencën, si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale, referuar standardeve të auditimit.

Auditimi u krye nga:

A. M, Përgjegjës Grupi,

Xh. K, anëtare,

Sh. H, anëtare.

Auditimi ka filluar më datë 16.12.2024.

Auditimi ka përfunduar më datë 17.01.2024.

Ky auditim është kryer në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe Udhëzimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 1, datë 04.11.2016 “Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dhe dokumentacion që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH”.

### **I/2. Objekti i Auditimit**

Bazuar në rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ky auditim ka si objekt, verifikimin në subjekt (*terren*) zbatimin konkret të rekomandimeve të KLSH-së, pasqyrimin e rasteve të shmangies nga këto rekomandime (*sidomos ato me impakt negativ financiar në buxhet*) dhe vlerëson aspektet e vendimmarrjes së Titullarëve të Institucioneve Publike, në drejtim të rritjes së performancës, me synim përmirësimin e metodës së punës, marrjen e masave të nevojshme strukturore, disiplinore apo ligjore shoqëruar me dëmshpërblimin e dëmit ekonomik të shkaktuar buxhetit të shtetit, nga nëpunësit publikë përgjegjës të subjekteve të audituara.

### **I/3. Qëllimi i Auditimit**

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 të nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

### **I/4. Metodologjia e Auditimit**

Nëpërmjet dërgimit të rekomandimeve në subjektet e audituara, KLSH realizon funksionin këshillues, duke respektuar pavarësinë institucionale, në përputhje me kërkesat e ISSAI 1, Deklarata e Limës “Udhëzime mbi rregullat e auditimit”, ISSAI 10, Parimi 7, Deklarata e Meksikos, “Ekzistencën e mekanizmave efektive ndjekës në rekomandimet e SAI-ve”, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), për të rritur përgjegjshmërinë e nëpunësve publikë, në pranimin e përgjegjësive dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese dhe përmirësuar punën për të ardhmen i devijimeve nga standardet e pranuar dhe identifikimi i rasteve të shkeljes së parimeve të, ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, përputhshmëria me kriteret e përcaktuara nga ligjet që rregullojnë funksionimin e njësisë të pushtetit vendor, të menaxhimit financiar me qëllim përmirësimin e funksionimit të njësisë në të ardhmen.

## **I/5. Konkluzioni**

Raporti përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit me shkresën nr. 562/19 prot., datë 28.12.2023. Grupi i auditimit zhvilloi auditimin mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i fundit i KLSH-së ku rezultoi se nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit kanë filluar të merren masa lidhur me zbatimin e 15 rekomandimeve organizative, 1 masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të tyre dhe për 32 punonjës masa disiplinore të lëna në total, të cilat janë pranuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Masa organizative

- Nga 15 masa organizative, janë zbatuar 9 rekomandime: 4 rekomandime janë zbatuar pjesërisht dhe 2 rekomandime nuk janë zbatuar.

Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të tyre.

- Nga 1 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të tyre, 1 rekomandim është zbatuar pjesërisht dhe është në proces.

Masa disiplinore

- Për 32 punonjës me masa disiplinore, zbatuar.

## **II. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MJEDISIT**

### 1. Auditimi i fundit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

Auditimi i fundit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit është kryer në vitin 2023 për periudhën 01.01.2022-31.12.2022. Raporti Përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar me shkresën nr. 562/19 prot., datë 28.12.2023, AKM nr. 12 datë 03.01.2024. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se, në përfundim të auditimit janë rekomanduar gjithsej:

- 15 masa organizative, pranuar nga subjekti;
- 1 masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të tyre, pranuar nga subjekti;
- Për 32 punonjës masa disiplinore, pranuar nga subjekti.

### 2. Hartimi i Planit të Veprimit dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

Në zbatim të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, gërma “j”, Agjencia Kombëtare e Mjedisit duhet të hartojë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve brenda 20 ditëve nga marrja e Raportit Përfundimtar të auditimit. Nga auditimi u konstatua se, Agjencia Kombëtare e Mjedisit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të dërguara me shkresë nr. 562/19 prot., datë 28.12.2023 ka kthyer përgjigje në KLSH brenda afatit ligjor prej 20 ditësh, me shkresë nr. 12/2 prot., datë 19.01.2024 dhe rezultoi se është hartuar Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve duke përcaktuar edhe strukturat përgjegjëse sipas llojit të rekomandimit, me shkresë nr. 12/1 datë 19.01.2024 të AKM-së.

3. Respektimi i afatit ligjor 6 - muhor nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Referuar shkresës nr. 562/19 prot., datë 28.12.2023, për dërgimin e Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimeve është plotësuar afati 6 - muhor për të raportuar lidhur me plotësimin e përcaktimeve të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2, “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”. Sipas verifikimit Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën (AKM) nr. 7092 datë 28.06.2024.

4. Mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e fundit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit

Në përfundim të auditimit janë rekomanduar masat si vijon:

*Në auditimin e fundit KLSH i ka rekomanduar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit 15 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht.*

**1- Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zhvillimit të procedurave të prokurimeve u konstatua se, në **3 raste** në prokurimet e kryera nga Autoriteti Kontraktor konkretisht:

1. Urdhër Prokurimi Nr. 10, datë 17.07.2020, zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt “Shërbimi i mirëmbajtjes së stacioneve të monitorimit të cilësisë së ajrit urban”;
2. Urdhër Prokurimi Nr. 5, datë 25.03.2021, zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt “Shërbimi i mirëmbajtjes së pajisjeve të instaluara në stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit urban në qytetet: Durrës, Shkodër, Korçë, Elbasan, Fier, Stacioni lëvizës”;
3. Urdhër Prokurimi Nr. 134, datë 16.06.2022, zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje reagentësh dhe materiale laborator”.

- Njësia e prokurimit, në hartimin e DST, kriteret e veçanta të kualifikimit, “Kapaciteti teknik”, ka kërkuar: “Dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se vlera 40% e vlerës së fondit limit, të kryera gjatë tre viteve të fundit”, si dhe “Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë sa 40% e vlerës së fondit limit, të kryera gjatë tre viteve të fundit”, duke vepruar në kundërshtim me (VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 3 ç’fuqizuar), VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 40, pika 4.

**Në 1 rast**, Urdhër Prokurimi Nr. 09, datë 05.05.2022, zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Shërbim projektimi i godinës së agjencisë”. Në dosjen e paraqitur, nuk u gjet dokumentacion nga Njësia e Prokurimit, lidhur me sigurimin dhe hartimin e specifikimeve teknike/termat e referencës si dhe për përlllogaritjen e fondit për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve që do të prokurojë.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2000 “Për prokurimin publik”, neni 124; ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin e Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011, ” Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” (Më hollësisht trajtuar në faqet 29-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1- Rekomandimi:** Njësia e Prokurimit të Autoritetit Kontraktor për çdo procedurë prokurimi të marrë masa që në hartimin e kriterëve të veçanta të plotësojnë Dokumentet Standarde të Tenderit në përputhje me rregullat e prokurimit publik për të mundësuar trajtim të barabartë dhe konkurrues midis konkurrentëve pjesëmarrës.

**Në vijimësi**

*Nga verifikimi rezultoi se, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit janë zbatuar detyrimet dhe kërkesat ligjore që burojnë nga Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, VKM*

*nr.285/2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar si dhe udhëzimeve përkatëse të miratuara nga APP. Procedurat janë realizuar në Sistemin e Prokurimit Publik.*

**Zbatuar**

**2- Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zhvillimit të procedurave të prokurimeve me blerje të vogël u konstatua se:

**Në 1 rast,** prokurimi me vlerë të vogël në vitin 2022 “Shërbim eksperti për inspektimin dhe vlerësimin e gjendjes fizike dhe teknike të Stacioneve të Monitorimit të Ajrit”. Në dosjen e paraqitur, nuk u gjet dokumentacion i kërkuar sipas Ftesës për Ofertë, datë 16.03.2022 nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, lidhur me sigurimin dhe hartimin e specifikimeve teknike/termat e referencës, si dhe dokumentacion për punësimin e 2 inxhinierëve me eksperiencë të diplomuar në fushat elektronike, elektrike (pasi fotokopjet e paraqitura nuk vërtetojnë punësimin dhe marrëdhëniet e punës me këta inxhinierë). Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 76 “Kriteret detyruese për s’kualifikim” si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar me Vendimin Nr. 710, datë 24.11.2021), neni 56 “Procedura e prokurimit me vlerë të vogël” pika 4 (*Më hollësisht trajtuar në faqet 29-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1- Rekomandimi:** Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël në çdo procedurë prokurimi të marrë masa që të plotësojnë Dokumentet Standarde të Tenderit në përputhje me rregullat e prokurimit publik për të mundësuar pasqyrim të saktë të procedurës.

**Në vijimësi**

*Nga verifikimi me zgjedhje rezultoi se, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit janë zbatuar detyrimet dhe kërkesat ligjore që burojnë nga Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, VKM nr.285/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe udhëzimeve përkatëse të miratuara nga APP. Procedurat janë realizuar në Sistemin e Prokurimit Publik.*

**Zbatuar**

**3- Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i komunikimit shkresor midis AKM dhe QKB u konstatua se: në regjistrin e lejeve ekzistojnë leje me format të vjetër, VNM/Deklarata Mjedisore si dhe subjekte të pajisur me leje mjedisore apo VNM pa raportuar asnjëherë, konkretisht: 1274 Leje Mjedisore format i vjetër si dhe 590 VNM/Deklarata Mjedisore, nga të cilat rezultojnë se, subjekte disponuese të këtyre lejeve mjedisore aktualisht janë me status “pezulluar” dhe jo aktiv në 271 raste që korrespondojnë me leje mjedisore format i vjetër si dhe 71 raste që korrespondojnë VNM/Deklarata Mjedisore. Mos azhurnimi dhe përditësimi i të dhënave të subjekteve pajisur me leje mjedisore është veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet mjedisit”, i ndryshuar neni 30 pika 1 dhe 2 (*Më hollësisht trajtuar në faqet 41-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1- Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa që të planifikojë kryerjen e inspektimeve në subjekte të konstatuar me leje mjedisore model i vjetër për të mundësuar evidentimin e veprimtarisë ose jo dhe për rastet me shkelje t’i kërkojë Ministrin të Turizmit dhe të Mjedisit për pezullim apo shfuqizimin e lejeve mjedisore.

**Deri në 31.03.2024**

*Nga verifikimi rezultoi se, Nga ana e Drejtorisë së Shqyrtimit dhe Monitorimit të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve është bërë pasqyrimi i urdhrave të shfuqizimit të lejeve mjedisore ku akti është i emërtuar “Vendim për VNM paraprake”/“Vendim për VNM të Thelluar” në Regjistrin Kombëtar të Lejeve, Licencave dhe Autorizimeve në QKB. Gjithashtu janë njoftuar të gjithë subjektet posedues të këtyre lejeve. Agjencia Kombëtare e Mjedisit me shkresë nr. 9078prot., datë 31.10.2023 i ka kërkuar Inspektoratit Qendror anulimin e planifikimit të*

inspektimit në subjekte të konstatuar me leje mjedisore model i vjetër, referuar shkresës së MTM me nr. 8256/1prot., datë 24.10.2023 ku referuar një rasti të ngjashëm si organ epror i AKM shprehet: “..Ju bëjmë me dije se në bazë të pikës 1 të nenit 30 të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, konstatohet se leja është e pavlefshme juridikisht”.

**Pa zbatuar**

**3.2- Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Mjedisit në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Biznesit të marrë masa që të unifikojë bazën e të dhënave mbi Lejet Mjedisore mbi të cilën operojnë Drejtori e Sektorë në AKM, duke mundësuar edhe përditësimin unik të saj.

**Deri në 31.05.2024**

**Nga verifikimi rezultoi se,** me ndryshimet ligjore, respektivisht ndryshimet në ligjin Nr.10440 datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, me ligjin nr.67/2024 i cili në nenin 30/1 ka përcaktuar: “1. Aktet e emërtuara “Vendim për VNM paraprake”/“Vendim për VNM të Thelluar”/“Deklaratë mjedisore”, për të cilat aplikimi është kryer në Qendrën Kombëtare të Licencimit, në zbatim të Vendimit nr. 13, datë 4.1.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis”, të shfuqizuar, dhe rezultojnë të regjistruara aktive në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licencave, shfuqizohen për shkak të mos kategorizimit si leje, licencë apo autorizim, sipas legjislacionit në fuqi.

AKM, sipas komunikimeve shkresore me MTM dhe përgjigjet e MTM me nr. 5355 prot., datë 22.08.2024 dhe nr. 2196 prot., datë 22.08.2024, me shkresë nr. 9040, datë 28.08.2024 i është drejtuar QKB-së me lëndë: Kërkesë për informacion mbi listën e Lejeve Mjedisore (PN-të) me status “AKTIVE” në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizime dhe Lejeve të lëshuara nga QKB për periudhën 2013-2016 sipas Vendimit Nr.13, datë 04.01.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis”. Nga QKB me nr. 1266/1 prot., datë 18.09.2024 janë vënë në dispozicion listat e kërkuara.

AKM pas listës së ardhur nga QKB-ja ka ngritur grupin e punës në bazë të Urdhrit Nr.227, datë 08.10.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për realizimin e procedurës administrative në zbatim të nenit 30/1 të ligjit Nr.10440 datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i ndryshuar. (Bashkëlidhur urdhri 227)

Në datë 15.10.2024 Komisioni i Verifikimit i ngritur me Urdhrin nr. 227, datë 08.10.2024 ka klasifikuar 72 PN janë me akt “Deklaratë Mjedisore dhe 343 PN me akt “Vendim për VNM paraprake” Në datë 23.10.2024 është mbledhur Komisioni për vlerësimin e propozimeve për revokim/pezullim.

AKM me nr. 11066 prot., datë 24.10.2024 ka dërguar MTM-së kërkesë për shfuqizimin e 72 PN që janë me akt “Deklaratë Mjedisore” dhe janë hartuar aktet për c’ fuqizimin e 343 PN me akt “Vendim për VNM paraprake”, publikuar urdhrat e shfuqizimit së bashku me njoftimin për të gjithë subjektet posedues të këtyre lejeve.

AKM për zbatimin e ndryshimeve ligjore të mësipërme ka proceduar me Urdhrin Nr.616, datë datë 19.12.2024 dhe Nr.617, datë 19.12.2024 (bashkëlidhur). Për marrjen e masave të unifikimit të bazës së të dhënave për Lejet e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka nisur procesin e bashkëpunimit për ndërtimin e një sistemi të integruar dhe të unifikuar, në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Biznesit, nëpërmjet AKSHI-it dhe institucionit epror të saj Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit si më poshtë:

Në vijimësi, Drejtoria e Shqyrtimit dhe Monitorimit të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve çdo fillim muaj përditëson data bazën, e përcjellë atë në të gjitha drejtoritë e agjencisë, njëkohësisht përcjell për publikim në WEB-in e institucionit.

Spektori i Shqyrtimit Teknik të Lejeve Mjedisore, pranë Drejtorisë së Shqyrtimit dhe Monitorimit të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve, hedh aktet në sistemin elektronik online, të cilat publikohen

në Regjistrin Kombëtar të Lejeve, Licencave dhe Autorizimeve, pranë QKB-së. Në WEB-in e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit “Publiku/Faturat - Agjencia Kombëtare e Mjedisit” është publikuar regjistri i të dhënave për leje mjedisore dhe VNM paraprake/të Thelluar.

**Zbatuar**

**4- Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në 13 raste për të njëjtin instalim nga i njëjti subjekt ka dy apo më shumë leje mjedisore (PN) të lëshuar në vite, megjithëse është aprovuar Leja Mjedisore e re, në asnjë rast nuk është revokuar Leja Mjedisore e vjetër, konkretisht:

Nr.	Emri Subjektit	NIPT	Vitet e Lejeve Mjedisore
1	P G T	K S	2014-2022
2	A. W.	K.B	2013-2022
3	A b H	K.E	2013-2016
4	A G 2015	L.F	2012-2016
5	D	L.A	2012-2018
6	A B	J.D	2011-2018
7	P.M	K.B	2011-2018
8	A	K.T	2011-2015-2018
9	T	K.I	2011-2012 s'ka të re
10	B. T	J.F	2011-2021
11	P. X	K.O	2011-2013
12	M. P.t	K.H	2011-2019
13	A. G. T.	L.C	2011-2022

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet mjedisit” i ndryshuar neni 8 “Kërkesat e përgjithshme për përdorimin e lejes së mjedisit të tipit A”, pika 1 dhe pika 2; neni 20 “Kërkesat e përgjithshme për funksionimin e lejes së mjedisit të tipit B” pika 1 dhe pika 2, si dhe neni 30 pika 1 dhe pika 2 (*Më hollësisht trajtuar në faqet 41-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**4.1- Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe të Mjedisit të marrë masa që të kërkojë revokimin e lejeve model i vjetër nga subjektet “P. G. T.” me NIPT K.S; “A. W” me NIPT K.B; “A. B. H” me NIPT K.E; “A. G 2015” me NIPT L.F; “D” me NIPT L.A; “A. B” me NIPT J.D; “P.M” me NIPT K.B; “A” me NIPT K.T; “T” me NIPT K.I; “B. T.” me NIPT J.F; “P. X” me NIPT K.O dhe “M. P” me NIPT K.H.

**Deri në 31.03.2024**

*Nga verifikimi rezultoi se, Komisioni Teknik në bazë të Urdhrit Nr.117, datë 18.05.2023 për “Krijimin e Komisionit Teknik për Vlerësimin dhe shqyrtimin e propozimeve për revokimin/pezullimin e Lejeve Mjedisore të Tipit A dhe B”, pas verifikimeve përkatëse, i ka propozuar MTM-së shfuqizimin e lejeve të mjedisit. Në datë 18.03.2024 AKM-ja dërgoi pranë MTM-së propozimet për shfuqizimet e lejeve mjedisore për subjektet e përcaktuar në tabelë. MTM si organ epror dhe vendimmarrës, është shprehur si më poshtë:*

- “P. G. T”, Urdhri Nr.308, datë 27/08/2024 mbi shfuqizimin e lejes PN-7158-04-2014.
- “A. W”, Urdhri Nr.306, datë 27/08/2024 mbi shfuqizimin e lejes PN-5784-07-2013.
- “A. B. H”, Urdhri Nr.304, datë 27/08/2024 mbi shfuqizimin e lejes PN-5853-07-2013.
- “A.G 2015”, Urdhri Nr.309, datë 27/08/2024 mbi shfuqizimin e lejes PN-3721-06-2012.
- Për subjektin “D”, propozimi është dërguar në MTM dhe nuk ka ardhur shfuqizimi dhe qëndrimi i MTM-së.
- “A. B”, Urdhri Nr.327, datë 06/09/2024 mbi shfuqizimin e lejes PN-1427-02-2011.
- “P”, Urdhri Nr.311, datë 27.08.2024 mbi shfuqizimin e lejes PN-1830-05-2011.
- “A”, Urdhri Nr.310, datë 27.08.2024 mbi shfuqizimin e lejes PN-1873-05-2011.
- Për subjektin “T”, propozimi është dërguar ne MTM dhe nuk ka ardhur shfuqizimi dhe qëndrimi i MTM-së.
- “B. T”, Urdhri Nr.288, datë 12.08.2024 mbi shfuqizimin e lejes PN-2365-10-2011
- “P.X”, Urdhri Nr.429, datë 15.11.2024 mbi shfuqizimin e lejes PN-2091-08-2011.
- “M. P”, Urdhri Nr.312, datë 27.08.2024 mbi shfuqizimin e lejes PN-2536-11-2011.

- “A. G. T”, Urdhri Nr.305, datë 27.08.2024 mbi shfuqizimin e lejes PN-2537-11-2011.

**Zbatuar**

**5- Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se **në 15 raste** nga komisioni i verifikimit dhe shqyrtimit të kërkesave për miratimin të lejeve mjedisore në AKM janë miratuar kërkesa në mungesë dokumentacioni të kërkuar ligjor

-**Në 1 rast**, në mbledhjen e komisionit nr. 25 i zhvilluar në datë 25.06.2020 u shqyrtua kërkesa e subjekti “A. K”. Nga AKM nuk ka sqarime të dokumentuara për mos zbatimin e afatit të lëshimit dhe publikimit të Lejes mjedisore të përcaktuar në Kreu III “Procedurat për shqyrtimin e kërkesave dhe përcaktimi i kushteve për leje mjedisi të tipit B”

-**Në të 8 rastet** nga komisionet janë miratuar Lejet Mjedisore për subjektet, por në dokumentacionin e paraqitur si dhe në sistem nuk ka të ngarkuar VNM. Konkretisht: Në mbledhjen e Komisionit nr. 8 i zhvilluar në datë 04.03.2021.2021 u shqyrtua kërkesa e subjektit “N. 2010” LC 64161. Në mbledhjen e komisionit nr. 3 i zhvilluar në datë 12.02.2021 janë shqyrtuar kërkesat e subjekteve “E”; “A. A.” LC 9160 dhe “B. T”. Në mbledhjen e komisionit nr. 8 i zhvilluar në datë 26.02.2020 u shqyrtua kërkesa e subjektit “E-R” LC 1275. Në mbledhjen e komisionit nr. 48 i zhvilluar në datë 24.12.2020 u shqyrtua kërkesa e subjektit “V.A.L.E. R” LC 3162. Në mbledhjen e komisionit nr. 6 i zhvilluar në datë 11.02.2020 u shqyrtua kërkesa e subjektit “A”. Në mbledhjen e Komisionit nr. 2 i zhvilluar në datë 22.01.2020 u shqyrtuan kërkesa e subjektit “R. O” LC 6325. Në mbledhjen e komisionit nr. 16 i zhvilluar në datë 27.04.2020 u shqyrtua kërkesa e subjektit “E. A”.

-**Në 2 raste**, në mbledhjen e komisionit nr. 14 i zhvilluar në datë 10.04.2020 u shqyrtua kërkesa e subjektit “Z. P” LC 8285 dhe në mbledhjen e komisionit nr. 3 i zhvilluar në datë 12.02.2021 u shqyrtua kërkesa e subjektit “E. E” LC 7860 nga ku, në dokumentacionin e paraqitur si dhe në sistem nuk ka kontratë për depozitim dhe ka kontratë për depozitim mbetjesh lidhur më 01.07.2021 me “N. B” në adresën Bashkia Vau i Dejës Nj.A. Bushat, ndërkohë veprimtaria zhvillohet në Durrës.

-**Në 1 rast**, në mbledhjen e komisionit nr. 6 i zhvilluar në datë 11.02.2020 u shqyrtua kërkesa e subjektit “A” nga ku, aplikimi është pranuar pa dokumentacionin për shkarkimin e ujërave teknologjike.

-**Në 1 rast**, në mbledhjen e komisionit nr. 64 i zhvilluar në datë 24.05.2022 u shqyrtuan kërkesa e Subjekti “K.F” nga ku, në dosjen e vënë në dispozicion për auditim (formatin PDF) nuk ka Formularin e dëgjimit në publik .

-**Në 1 rast**, në mbledhjen e komisionit nr. 53 i zhvilluar në datë 06.05.2022 u shqyrtuan kërkesa e subjektit “P. X” ku, nga dokumentacioni i paraqitur në PDF si dhe ngarkuar në sistem pagesa e tarifës është bërë në datë 15.04.2022 pas datës së aplikimit, i cili mban datën 17.03.2022.

-**Në 1 rast**, në mbledhjen e Komisionit nr. 48, i zhvilluar në datë 06.10.2021 u shqyrtua kërkesa e subjektit “A&C” LC 7088 ku ka miratim në heshtje, pa akt-miratimi Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, neni 4; nenin 8 “Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të VNM-së” të ligjit nr. 10440, datë 7.7. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar; ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”; VKM nr. 575, datë 24.6.2015; VKM nr. 419, datë 25.06.2014, si dhe VKM nr. 538, datë 26.5.2009 (Më hollësisht trajtuar në faqet 41-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1- Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe të Mjedisit të marrë masa që të kërkojë revokimin e lejeve mjedisore të miratuar pa dokumentacionin e kërkuar ligjor për subjektet: “N 2010”; “E”; “A. A”; “B. T”; “E-R”; “V.A.L.E. R”; “A”; “R. O”; “E. A”; “Z. P”; “E. E”; “K.F”; “P. X”; “A&C”.

**Deri në 31.03.2024**

***Nga verifikimi rezultoi se, Komisioni i mbledhur në lidhje me rekomandimin nr.5.1 të Raportit Përfundimtar të KLSH-së sipas procesverbalit nr.3463/6 prot., datë 08/04/2024 ka vendosur inspektimin mbi këto subjekte si dhe njoftimin e tyre mbi shlyerjet e detyrimeve financiare.***

*Nga ana e inspektoratit është kryer verifikimi i lejeve mjedisore me PN-të respektive, pranë këtyre operatorëve dhe në përfundim të inspektimit ka rezultuar të kenë plotësuar kushtet e vendosura në lejet mjedisore që disponojnë mbështetur në procesverbalin me Nr.3463/7Prot., datë 29.05.2024.*

***Aktualisht:***

*-Operatori “E. R” me Leje mjedisore me PN-9901-03-2020, të përmendur në këtë rekomandim është e shfuqizuar në Regjistrin Kombëtar të Autorizimeve, Lejeve dhe Licencave pranë QKB-së, me urdhër nr. 62, datë 17.02.2023.*

*-Operatori “Z. I” është i pajisur me Licencë III.2.B, me Leje mjedisore me PN-9728-12-2019 nr. identifikimi 3106, nr. 11391 prot., datë 30.12.2019 për zhvillimin e aktivitetit “Rikuperim i mbetjeve jo të rrezikshme. Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme.” Mbetje të cilat trajtohen/rikuperohen nga vet operatori në mbështetje të ligjit Nr. 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve.*

***Pjesërisht***

**6- Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Sektori i Monitorimit në Drejtorinë e Inspektimit dhe Kontrollit në AKM nuk ka bërë evidentimin e subjekteve të pajisur me leje mjedisore A dhe B në lidhje me likuidimin e tarifës vjetore të lejeve detyrë kjo funksionale e përcaktuar në rregulloren e AKM-së. Veprim në kundërshtim me VKM nr. 417, datë 25.6.2014 “Për miratimin e tarifave të lejeve të Mjedisit” (ndryshuar me VKM-në nr. 462, datë 26.7.2023) (*Më hollësisht trajtuar në faqet 41-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**6.1- Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa për të hartuar një bazë të dhënash unike ku të përcaktohen detyrimet e pagesës të tarifave vjetore të lejeve mjedisore nga subjektet që rezultojnë në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licencave, në QKB me përditësimin nga arkëtimet.

**Deri në 31.05.2024**

***Nga verifikimi rezultoi se, Drejtoria e Shqyrtimit dhe Monitorimit të Lejeve Mjedisore dhe VNM çdo muaj përditëson data bazën e të dhënave dhe e shpërndan në drejtoritë e AKM-së, brenda javës së parë të çdo muaji. Gjithashtu në të njëjtën kohë kërkon dhe përditësimin në WEB. Data bazat gjenden ne linkun: <https://akm.gov.al/publiku/>***

***Zbatuar***

**7- Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se:

- Nga verifikim i pajisjeve me Kod Unik Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit për 6 subjekte ka miratuar 13 kode unik, kemi miratime të Kodit Unik sa herë subjekti ka aplikuar për ndryshim të licencës, ndryshim kodesh mbetjesh si dhe shtim të vendndodhjeve.

- Për periudhën objekt auditimi nuk ka patur një rakordim/ndërveprim të dokumentuar midis Drejtorive Teknike dhe Inspektoratit në AKM pasi: Regjistri i licencave nuk është i mirë organizuar; Regjistri Kombëtar i Transfertave të Mbetjeve jo të Rrezikshme nuk është i azhurnuar në kohë me raportimet e transfertave dhe regjistrimet e Kodit Unik nga subjekte të pajisur me licencë III.2.B.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, në nenet 62 dhe 63; VKM nr. 229, datë 23.4.2014, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”, (ndryshuar me VKM nr. 1031, datë 16.12.2020), Pika 19; si dhe VKM nr. 371, datë 11.6.2014, “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre” (ndryshuar me VKM nr. 1032, datë

16.12.2020), Pika 25 (Më hollësisht trajtuar në faqet 41-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1- Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Mjedisit t'i kërkojë Ministrinë e Turizmit dhe të Mjedisit për të marrë masa për revokimin e më shumë se një Kodi Unik për të 6 subjektet: "V.A.L.E. R"; "4 A-M"; "A. P"; "E.P"; "G. C."; "E".

**7.2- Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa që: Regjistri Kombëtar i Transfertave të Mbetjeve jo të Rrezikshme të azhurnohet në kohën reale të transfertave të deklaruar për të patur shkëmbim informacioni shkresor midis Drejtorive Teknike dhe Inspektoratit në AKM.

**Deri në 31.03.2024**

**1. Nga verifikimi rezultoi se,** AKM me anë të shkresës me nr. 10467 prot., datë 09.10.2024 i është drejtuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për ngritjen e një grupi pune për verifikimin e licencave të nënkategorisë III.2.B në lidhje me problematikat e hasura. Gjithashtu më datë 22.10.2024 me anë të shkresës me nr. 10467/1 prot., Agjencia është drejtuar ministrisë për plotësimin e kuadrit ligjor për nxjerrjen e akteve nënligjore të parashikuara në nenet 23, 25 dhe 57 të ligjit të Licenca III.2.b. (bashkëlidhur shkresat).

Më datë 1.08.2024 janë miratuar VKM nr. 522 dhe VKM nr. 526, të cilat lejojnë që Kodi Unik të miratohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

**2. Nga verifikimi rezultoi se,** me Urdhrin nr. 193, datë 16.08.2023 AKM, ka ngritur grupin e punës "Për ngritjen e grupit të punës të kontrollin dhe verifikimin në terren të subjekteve të pajisura me licencë III.2.b". Në zbatim të urdhrin grupi i punës ka përgatit Memo nr. 6375/1prot., datë 21.08.2023 me lëndë: "Informacion mbi zbatimin e urdhrin nr. 193, datë 16.08.2023". Në vijimësi të raportimit të bërë në periudhën 1-15 Nëntor 2024 është në përpunim e sipër lista e plotë e operatorëve që kanë plotësuar detyrimin e raportimit.

Sistemi integruar mjedisor është në fazën e ndërtimit nga kompania që është shpallur fituese.

**Pjesërisht**

**8- Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se **në 4 raste** ka miratime të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis në shkelje të procedurave ligjore konkretisht:

-**Në 1 rast** kemi miratim të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis **Subjekti "B"** me Komisionin nr. 64 Tiranë, më 23.12.2020 për projektin "Dallgëthyese (pistë) dhe stacion shërbimi", Qerret, Kavajë. Miratimi i VNM pasi ka mbaruar vepra si është cilësuar edhe në raportin teknik të paraqitur.

-**Në 2 raste**

- **Subjekti "A.S"** nga AKM me Vendimin nr. 7, datë 07.02.2020 ka miratuar Deklaratën Mjedisore, me dokumentacion për dëgjuesën me publikun në vendndodhjen e instalimit mbajtur në 13.11.2018 jo konform modelit të përcaktuar dhe pa pjesëmarrje publiku të dokumentuar me nënshkrime të rregulla nga ana vizuale. Megjithëse AKM me shkresë nr. 3105, datë 20.06.2019 "Njoftim për vazhdim procedurë të VNM të Thelluar" në qëndrimin e saj ka kërkuar plotësimin e informacionit me Konsultimin me publikun.

- **Subjekti "G.E.",** Komisioni me nr. 06, datë 03.02.2022 ka miratuar "Deklarata Mjedisore" për projektin "Instalime për prodhimin e energjisë hidroelektrike" (Ndërtim HEC "Guri i Bardhë 1 dhe 2) subjektit "G. E".

- Nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura janë vendosur kushte në lidhje me afërsinë e objektit me Zonën të Mbrojtur.

- Në historikun e aplikimit pasqyruar në sistem konstatohet se në datë 07.09.2021 nga Njësia e Qeverisjes Vendore Klos është marrë "Aprovim automatik në heshtje" nga kërkesa e dërguar po në datë 31.08.2021. Nga Agjencia Rajonale e Mjedisit nuk është e dokumentuar qëndrimi i banorëve që kanë marrë pjesë në peticionin kundër objektit, si dhe nuk ka sqarime apo korrespondencë me NjQV Klos mbi peticionin e banorëve për të cilin është shprehur në shkresën e datës 21.04.2020.

- Në 1 rast me Vendimi nr. 45, datë 26.08.2020, vendosi Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për zhvilluesin, person juridik: **“G.G” sh.p.k.** Në dokumentacionin e administruar në sistemin “E-leje” nuk ka shkresë nga AKZM në shqyrtim të pozicionimit të karrierës në lidhje Zonën e Mbrojtur çka përbën kusht për shqyrtimin dhe dhënien e lejes mjedisore

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10 440, datë 07.07. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”; VKM nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore” (*Më hollësisht trajtuar në faqet 65-70, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**8.1- Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa që të planifikojë kryerjen e inspektimeve në subjekte: “B”; “A.S”; “G. E” dhe “G.G”, për vlerësimin e raportit të ndikimit në mjedis.

**Deri në 31.03.2024**

*Nga verifikimi rezultoi se, Sektori i Shqyrtimit Teknik të VNM-së, Drejtoria e Shqyrtimit dhe Monitorimit të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve i ka vënë në dispozicion Drejtorisë së Inspektimit Kontrollit aktet dhe vendimet e VNM-ve. Nuk ka plan pune për inspektim për subjektet: “B”; “A.S”; “G. E” dhe “G.G”, për vlerësimin e raportit të ndikimit në mjedis.*

**Pazbatuar**

**9- Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në 9 raste në kryerjen e inspektimeve referuar dokumentimin on-line ka parregullsi në konstatimin e shkeljeve dhe aplikimin e sanksioneve administrative, konkretisht:

- Procesverbali i inspektimit datë 25.08.2020; Vendimin Përfundimtar të Inspektimit nr. 5, datë 28/09/2020 në subjektin **“E” shpk NIPT K.Ë.** Grupi i inspektimit në dokumentacionin e inspektuar nuk ka paraqitur pajisjen e subjektit “E.K” me Licencë III. 2. B, si dhe paraqitja regjistrave për menaxhimin e mbetjeve nuk është në përputhje me kërkesat ligjore. Për këtë nuk është vepruar me masat administrative të përcaktuara në ligjin nr. 10463/2011.

- Procesverbali i inspektimit datë 03.11.2021 në subjektin **“A.C” shpk NIPT K.Ë,** dhe procesverbali i inspektimit datë 03.11.2021 në subjektin **“11 H” shpk NIPT K.Ë.** Vendimet e inspektimit në të dy rastet korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm.

- Procesverbali i inspektimit datë 04.11.2021 në subjektin: **“G. D. F” me NIPT L.M.** Shkeljet e konstatuara klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative: Dënim administrativ kryesor: Gjobë: 500,000 lekë; Gjobë: 300,000 lekë; Gjobë: 1,000,000 lekë; Gjobë: 300,000 lekë. Aplikimi i dënimit kryesor me gjobë sipas shkeljeve të konstatuara në procesverbalin e datës 04.11.2021 dhe marrja e Vendimit datë 24.11.2021 për mos aplikimin e dënimit administrativ me gjobë në 4 raste nuk mbështetet dokumentacionin e administruar si dhe nuk argumentohet ligjërisht nga inspektorët përgjegjës.

- Procesverbali i inspektimit datë 30.06.2022, në subjektin: **“4 A-M” me NIPT K.L.** Në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit datë 14.07.2022 është përcaktuar: Nuk ka dënim administrativ dhe është cilësuar *“Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive”.* Nuk është argumentuar mos aplikimi i masës administrative gjobë.

- Procesverbali i inspektimit datë 12.05.2022 në subjektin: **“B. V 2013” me NIPT L.V.** Nga Inspektorët nuk është konstatuar shkelja e mos pagesës së tarifës jashtë afatit në datë 10.05.2022. Nuk ka dokumentacion për argumentimin e mos aplikimit të gjobës së propozuar në procesverbal datë 12.05.2022, dhe marrjen e masës administrative “Paralajmërim”.

- Procesverbali i inspektimit datë 16.11.2022 në subjektin: **“C. L” NIPT: L.C.** Nuk ka dokumentacion për mos aplikim të gjobës për shkeljen e konstatuar. Në Vendimin

Përfundimtar të Inspektimit datë 14/12/2022 është përcaktuar: Nuk ka dënim administrativ “..Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive”.

- Procesverbali i inspektimit datë 23.11.2022 në subjektin “**D.B**” me NIPT **K.R.** Shkeljet e konstatuara klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënime administrative: Dënim administrativ kryesor: Gjobë: 300,000 lekë. Aplikimi i dënimit kryesor me gjobë sipas shkeljeve të konstatuara në procesverbalin e datës 23.11.2022 dhe marrja e Vendimit datë 16/12/2022 për mos aplikimin e dënimit administrativ.

- Proces-verbali i inspektimit datë 03.06.2022 në subjektin “**P**” me NIPT: **J.G.** Shkeljet e konstatuara klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënime administrative: Dënim administrativ kryesor: Gjobë: 300,000 lekë; Gjobë: 1,000,000 lekë; Aplikimi i dënimit kryesor me gjobë sipas shkeljeve të konstatuara në procesverbalin e datës 04.11.2021 dhe marrja e Vendimit datë 01.07.2022 për mos aplikimin e dënimit administrativ me gjobë në 2 raste nuk mbështetet në dokumentacionin e administruar si dhe nuk argumentohet ligjërisht nga inspektorët përgjegjës të inspektimit.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10448 "Për Lejet e Mjedisit", datë 7/14/2011, i ndryshuar, neni 29, pika 1; ligjin nr.10463, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", datë 22.09.2011 i ndryshuar, nenin 21, pikat 9, 10 dhe nenin 57, si dhe VKM nr. 229, datë 23.4.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit", (ndryshuar me VKM nr. 1031, datë 16.12.2020).

Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", Urdhri nr. 13, datë 23.04.2015, Inspektorati Qendror pranë Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit" pika 4-6 e Manualit të Përgjithshëm (*Më hollësisht trajtuar në faqet 70-92, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**9.1- Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Drejtorja e Inspektim Kontrollit të marrë masa për të analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për aplikimin e dënimeve administrative në procesverbalet e inspektimit dhe anulimin e tyre në vendimet e marra, si dhe të planifikojë inspektime për verifikim e konstatimeve dhe detyrave të lëna nga inspektimet në subjektet e inspektuara si dhe subjektet: "E" sh.p.k NIPT: K.Ë; "A.C" sh.p.k NIPT: K.Ë; "11 H" sh.p.k NIPT: K.Ë; "G. D. F" NIPT: L.M; "4 A-M" NIPT: K.L; "B. V 2013" NIPT: L.V; "C L" NIPT: L.C, "D. B" NIPT: K.R dhe "P" NIPT: J.6G.

**Deri në 31.03.2024**

*Nga verifikimi rezultoi se, Subjektet e cituara me lart janë inspektuar gjatë vitit 2024 sipas kronologjisë:*

- "E" shpk me NIPT: K.Ë, janë hapur çështjet me numër AKM-FR-2024-000269 me datë 28.11.2024 dhe mbyllur me datë 16.12.2024, çështja me numër AKM-BR-2024-000203 është hapur me datë 27.08.2024 dhe mbyllur me datë 04.09.2024, si dhe çështja me numër AKM-BR-2024-000028 me datë 25.01.2024 dhe mbyllur me datë 05.02.2024.

- "A.-Cj" shpk me NIPT: K.Ë, është hapur çështja me numër AKM-DQ-2024-000515 me datë 04.11.2024 dhe mbyllur me datë 07.11.2024.

- "11 H" shpk me NIPT: K.Ë, ka të njëjtin NIPT me subjektin "A.C".

- "G. D. F" me NIPT: L.M, është hapur çështja me numër AKM-TR-2024-000088 me datë 30.05.2024 dhe mbyllur me datë 10.06.2024.

- "4 A-M" me NIPT: K.L, është hapur çështja me numër AKM-TR-2024-000197 me datë 09.09.2024 dhe mbyllur me datë 26.09.2024 si dhe çështja me numër AKM-LE-2024-000009 është hapur me datë 25.01.2024 dhe mbyllur me datë 27.02.2024.

- "B. V 2013" me NIPT: L.V, është hapur çështja me numër AKM-FR-2024-000158 është hapur me datë 31.07.2024 dhe mbyllur me datë 12.08.2024 si dhe çështja me numër AKM-FR-2024-000032 është hapur me datë 26.01.2024 dhe mbyllur me datë 28.02.2024.

-“C. L” me NIPT: L.C, është hapur çështja me numër AKM-LE-2024-000084 me datë 24.05.2024 dhe mbyllur me datë 04.06.2024 si dhe çështja me numër AKM-LE-2024-000024 është hapur me datë 25.01.2024 dhe mbyllur me datë 14.02.2024.

-“D. B” me NIPT: K.R janë hapur çështjet me numër AKM-BR-2024-000093 me datë 19.06.2024 dhe mbyllur me datë 19.06.2024, çështja me numër AKM-FR-2024-000071 është hapur me datë 27.05.2024 dhe mbyllur me datë 25.06.2024, çështja me numër AKM-BR-2024-000064 me datë 24.05.2024 dhe mbyllur me datë 10.06.2024 si dhe çështja me numër AKM-FR-2024-000041 është hapur me datë 26.01.2024 dhe mbyllur me datë 20.02.2024.

-“Pn” me NIPT: J.G, është hapur çështja me numër AKM-LE-2024-000140 me datë 27.08.2024 dhe mbyllur me datë 17.09.2024.

**Zbatuar**

**10- Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në 6 raste në kryerjen e inspektimeve referuar dokumentimin aniline ka parregullsi në konstatimin e shkeljeve dhe aplikimin e sanksioneve administrative, konkretisht:

**Në 1 rast,** Proces –verbali i inspektimit datë 08.06.2021 në subjektin “E” sh.p.k me NIPT: K.Ë. Grupi i inspektimit në dokumentacionin e inspektuar nuk ka paraqitur “Kontratë evadimi mbetje jo të rrezikshme” me subjekt të pajisur me Licencë III. 2. B, si dhe nuk referohen apo paraqiten Regjistrat për menaxhimin e mbetjeve. Duke mos vepruar me Masat Administrative **Në 5 raste:**

- Procesverbali i inspektimit datë 08.11.2022 në subjektin “B. B”.
- Procesverbali i inspektimit datë 09.11.2022 në subjektin “D. T”.
- Procesverbali i inspektimit datë 11.11.2022 në subjektin “Gj. L”.
- Procesverbali i inspektimit datë 08.06.2022 në subjektin “K. A. A”.
- Procesverbali i inspektimit datë 10.06.2022 në subjektin “N”.

Në procesverbalet e inspektimit nuk është cilësuar mbarimi i afatit të lejes së përdorimit të basenit ujqor por vetëm aplikimi për rinovim të lejes, dhe nuk theksohet që hyrja në fuqi e lejes së përdorimit bëhet “Pas publikimit në regjistrin kombëtar të licencave dhe lejeve”.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar; ligjin nr. 10463, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, datë 22.09.2011 i ndryshuar; VKM nr. 229, datë 23.4.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”, (ndryshuar me VKM nr. 1031, datë 16.12.2020); Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; Urdhri nr.13, datë 23.04.2015, Inspektorati Qendror pranë Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit” pika 4-6 e Manualit të Përgjithshëm (Më hollësisht trajtuar në faqet 70-92, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1- Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Drejtoria e Inspektimit Kontrollit të marrë masa të planifikoje inspektime për verifikim e konstatimeve dhe detyrave të lëna nga inspektimet në subjektet e inspektuara si dhe në subjektet: “B. B”; “D. T”; “Gj. L”; “K. A. A” dhe “N”, për verifikimin e pajisjes me leje përdorimi të basenit ujqor dhe aplikimin e kundërvajtjes administrative “gjobë”.

**Deri në 31.03.2024**

**Nga verifikimi rezultoi se:**

**Në rastin 1,** që i përket subjektit Erzeni shpk, NIPT: K32515022Ë, është inspektuar me numër AKM-FR-2024-000269 me datë 28.11.2024; me numër AKM-BR-2024-000203 me datë 27.08.2024; me numër AKM-BR-2024-000028 me datë 25.01.2024.

**Në rastin 2,** subjekti Beqir Boci (Boci 2020), NIPT: L82614202B, riinspektuar me nr. AKM-DQ-2023-000335, datë. 09.10.2023. Subjekti është i pajisur me leje të përdorimit të Burimeve Ujqore Nr. 916 Prot., datë. 25.11.2022, me vendim të KBU Shkumbin Nr.8, datë 21.11.2022.

*Në rastin 3, Subjekti Dritan Tashi, NIPT:L034052050, riinspektuar me NR, AKM-DQ-2023-000341, datë. 11.10.2023. Subjekti është i pajisur me leje të përdorimit të Burimeve Ujore Nr. 246 Prot., datë. 10.03.2023, me vendim të KBU Shkumbin Nr.8, datë 06.03.2023.*

*Në rastin 4, Subjekti Gjergji Lici, NIPT:K 83123202J, riinspektuar me NR, AKM-DQ-2023-000337, datë. 12.10.2023. Subjekti është i pajisur me leje të përdorimit të Burimeve Ujore Nr. 548 Prot., datë. 16.06.2023, me vendim të KBU Shkumbin Nr.15, datë 08.06.2023.*

*Në rastin 5, Subjekti Kilic Aquaculturë Albania (Coral Farm), NIPT:L 43403601A, riinspektuar me NR, AKM-DQ-2023-000260, datë. 29.09.2023. Subjekti është i pajisur me leje të përdorimit të Burimeve Ujore Nr.193 Prot., datë. 24.05.2022, me vendim të KBU Drin-Bunë Nr.7, datë 20.05.2022.*

*Në rastin 6, Subjekti Nordin, NIPT:J 97113015J, riinspektuar me NR, AKM-DQ-2023-000265, datë. 14.09.2023. Subjekti është i pajisur me leje të përdorimit të Burimeve Ujore Nr.369 Prot., datë. 26.09.2022, me vendim të KBU Drin-Bunë Nr.28, datë 22.09.2022.*

**Zbatuar**

**11- Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se nuk ka inspektime të kryera me indicie nga rezultatet negative laboratorike për mostrat e mara në instalimet e subjekteve që ndotin mjedisin, konkretisht:

Për periudhën objekt auditimi sipas indicieve janë kryer 33 analiza nga laboratorit i analizimit të mostrave, nga të cilat: 5 mostrat të marra sipas kërkesave të ardhura nga institucionet e tjera (Polici, Prokurori), 19 mostrat të marra sipas kërkesave të ardhura nga AKM apo Drejtoritë Rajonale të Mjedisit, si dhe 9 mostrat të marra sipas kërkesave të ardhura nga Taks-Forcë për sezonin turistik 2022.

Në asnjë rast nuk ka informim për Drejtorinë e Inspektimit e Kontrollit mbi rezultatet e analizimit si për ato që kanë rezultuar me shkelje të normave të lejuara për mjedisin edhe për ato që kanë rezultuar brenda normave të lejuara. Inspektimet e kryera në këto subjekte janë sipas planifikimit të DIK, dhe në asnjë rast nuk kanë lidhje me rezultatet e analizimit të mostrave të ardhura në laborator apo të marra nga vetë specialistët e laboratorit.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10448 “Për Lejet e Mjedisit”, datë 7/14/2011 i ndryshuar; ligjin nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i ndryshuar; ligjin nr.10463, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, datë 22.09.2011 i ndryshuar; Ligji nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; “Rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit” me nr. 120, datë 12.01.2021 (*Më hollësisht trajtuar në faqet 70-92, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**11.1- Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Mjedisit, të marrë masa:

-Të hartojë një bazë të dhënash të aksesueshëm mbi historikun e rezultateve të analizimit për subjektet në të cilët merren mostrat për analizim nga Drejtoria e Regjistrave Mjedisore e Inovacionit dhe Analizave Laboratorike.

-Të përcaktojë mënyrën shkresore për shkëmbim informacionesh midis drejtorive të AKM. Informacione këto për të përcaktuar riskun e inspektimeve dhe marrjen e masave për ndotësit e mjedisit.

**Deri në 31.03.2024**

*Nga verifikimi rezultoi se, Sektori i Analizave Laboratorike dhe Monitorimit të Kontratave, e ndryshuar, ka ngritur databazën historike të analizave të realizuara me kërkesë specifike nga institucionet e tjera. Bashkëlidhur Databaza. (është raportuar në 6 mujorin e parë).*

*Bazuar në Urdhrin e Kryeministrit nr.29, datë 13.02.2024 “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organizimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit” në datë 2 Maj 2024 ka filluar funksionimin Sektorit Mostrimit dhe Shkarkimeve në Mjedis në Drejtorinë e Menaxhimit të Dhënave Mjedisore, Kimikateve, Analizave Laboratorike dhe Inovacionit.*

**Zbatuar**

**12- Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se nga Drejtoria e Inspektimit dhe e Kontrollit për periudhën objekt auditimi janë hartuar e miratuar planë mujore inspektimi jo për tërë

periudhën vjetore respektive konkretisht:

**Nga Sektori i Inspektimit të Mjedisit:**

-Për periudhën Gusht-Dhjetor 2020, vetëm për muajin Shtator.

-Për periudhën Janar–Dhjetor 2021 për 8 muaj, Muajt Janar-Shkurt, Maj - Qershor, dhe Gusht - Nëntor.

-Për periudhën Janar–Dhjetor 2022, për 11 muaj, Shkurt–Dhjetor.

**Nga Sektori i Inspektimit të Ujërave**

-Për periudhën Gusht-Dhjetor 2020, për 2 Muajt Gusht dhe Shtator.

-Për periudhën Janar–Dhjetor 2021, për 4 Muajt Qershor–Korrik dhe Nëntor-Dhjetor.

-Për periudhën Janar–Dhjetor 2022, për 5 Muajt Qershor, Korrik, Gusht, Shtator, Nëntor.

Në asnjë rast nuk ka analizë risku, në përzgjedhjen e veprimtarive apo subjekteve për inspektim dhe në asnjë rast nuk ka planifikim të kontrolleve për rekomandimet e lëna për përmirësimin e situatës mjedisore në rastet e konstatimit të shkeljeve.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Urdhri nr. 13, datë 23.04.2015, Inspektorati Qendror pranë Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit” (*Më hollësisht trajtuar në faqet 70-92, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**12.1- Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Drejtoria e Inspektim Kontrollit të marrë masa:

- Në planet vjetore të planifikoje edhe inspektimet për verifikimin e rekomandimeve të lëna për përmirësimin e situatës mjedisore në rastet e konstatimit të shkeljeve.

- Në bazë të vlerësimit të riskut dhe përcaktimit të subjektet me risk të lartë me ndikim në mjedis. të hartojë Planin Strategjik të Inspektimeve dhe në përputhje e zbatim të tij të hartojë e të miratojë Planet Vjetore e Mujore të Inspektimeve.

**Deri në 31.03.2024**

*Nga verifikimi rezultoi se, është miratuar nga Drejtori i përgjithshëm i AKM-së “Matrica e Plotësisimit të Kushteve, Kërkesave, Parimeve dhe Menaxhimit Mjedisor” si dhe “Plani Strategjik i Inspektimit Drejtoria e Inspektim Kontrollit Agjencia Kombëtare e Mjedisit 2022-2025”, (dokumentet bashkëlidhur në formë elektronike- janë pa numër protokolli dhe datë). Drejtoria e Kontrollit dhe Inspektimit nuk ka të miratuar planin vjetor të inspektimeve. Sektori i inspektimit të mjedisit nuk ka plane mujore të miratuar për muajt mars-prill-maj 2024. Sektori i inspektimit të burimeve ujore nuk ka të miratuar planin mujor për muajt janar-mars-prill 2024. Gjithashtu, nuk ka të planifikuar inspektimet për verifikimin e rekomandimeve të lëna për përmirësimin e situatës mjedisore në rastet e konstatimit të shkeljeve.*

**Pjesërisht**

**13- Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i apelimeve të masave administrative u konstatua:

1.Subjekti “ Kurum International” me Nr. AKM-FR-2020-00007-5 datë, 25.09.2020 i është vendosur masë administrative gjobë 2.000.000 lekë. Nga konstatimi në shkelje të nenit 39 të Ligjit Nr. 110/2012 datë 15.11.2020 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore (i ndryshuar). Komisioni i AKM-së pasi ka shqyrtuar ankimimin administrativ referuar analizave dhe fakteve të pretenduara ka vendosur të shfuqizojë masën administrative të marrë, ne mbështetje të pikës 4 nenit 137, Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

2.Subjekti “Alb Kalystan” me Nr. AKM-TR-2020-000087-1 datë 12.11.2020 të Agjencisë Rajonale të Mjedisit i është vendosur masë administrative me vlerë 300.000 lekë. Subjekti është gjobitur ne shkelje “Për Lejet e Mjedisit”, për mos përmbushja dhe mosrespektimi i

kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatës të mjedisit të tipave A, ose B nga operatori në një instalimi.

të vendosur nga inspektorët e Agjencisë Rajonale të Mjedisit, Tirane, për shkelje të nenit 29 pika 1/b, "ii" të Ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit" i ndryshuar. Komisioni pasi shqyrtoi ankimin administrativ të subjektit, referuar fakteve të pretenduara, arsyetimit ligjor dhe masës administrative të marrë, në mbështetje të pikës 4 të nenit 137 të ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, vendosi: Shfuqizimin e masës administrative gjobë në vlerën 300.000 lekë.

3. Resort Prestige, objekti i aktivitetit: "Bar, restorant, berrari, hoteleri-turizëm import-eksport të mallrave të ndryshme industriale, bujqësore, ushqimore etj".

Komisioni. Ka në shqyrtimin e shkeljeve të konstatuar konkretisht:

a) në pikën 2/ç të nenit 23 të Ligjit Nr. 9115, datë 24.07.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotur" të ndryshuar që bën fjalë për shkarkime të pakontrolluara të ujërave të ndotura të patrajtuar, kur nuk ka kanalizime.

b) në nenin 62 të Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" i ndryshuar, që ka të bëjë me mosdorëzim të mbetjeve jo të rrezikshme (mbetje vaji ushqimor) një shoqërie të licencuar.

Argumenton që shkeljet qëndrojnë por në mënyrë të pa argumentuar ligjërisht ka vendosur shfuqizimin e masës administrative gjobë në vlerën 1,000,000 lekë.

4. Prive Services shpk, objekti i aktivitetit: "Hapje dhe menaxhim baresh, restorantesh, hotelesh, fast-food etj. Shërbime turistike."

Komisioni. Ka marrë në shqyrtimin e shkeljeve të konstatuar konkretisht

a) në pikën 2/ç të nenit 23 të Ligjit Nr. 9115, datë 24.07.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotur" të ndryshuar që bën fjalë për shkarkime të pakontrolluara të ujërave të ndotura të patrajtuar, kur nuk ka kanalizime.

b) në nenin 62 të Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" i ndryshuar, që ka të bëjë me mosdorëzim të mbetjeve jo të rrezikshme (mbetje vaji ushqimor) një shoqërie të licencuar.

Argumenton që shkeljet qëndrojnë, por në mënyrë të paargumentuar ligjërisht ka vendosur shfuqizimin e masës administrative gjobë në vlerën 1,000,000 lekë (*Më hollësisht trajtuar në faqet 92-107, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**13.1- Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Sektori i Ankimeve, (Apelim, Ekzekutim dhe Trajtim i Penaliteteve) në rastet e ndryshimeve të vendimeve të analizojë vendosjen e masave administrative të pa mbështetura ligjërisht duke propozuar edhe masa administrative për personat përgjegjës.

**Menjëherë e në vijimësi**

*Nga verifikimi rezultoi se, rekomandimi është marrë parasysh nga Sektori i Ankimeve gjatë shqyrtimit të ankimeve administrative në vazhdim dhe nga Komisioni i Ankimit në arsyetimin e vendimmarrjes.*

**Zbatuar**

## **B. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE FINANCIARE NEGATIVE**

**1- Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se nga mosrakordimi ndërmjet drejtorive dhe sektorëve të AKM-së për numrin e lejeve mjedisore, për vitet 2020 - 2021 evidentohet një diferencë tarife vjetore e pa arkëtuar prej 13 040 000 lekë. Gjithashtu nga evidentimi i bërë nga sektori i financës së AKM-së për periudhën 2015 deri më qershor 2020, janë evidentuar detyrime të tarifës vjetore për 840 subjekte në shumën 8 522 000 lekë. Në momentin e auditimit nga Sektorin e Financës në AKM nuk disponohet lista e 840 subjekteve debitorë (*Më hollësisht trajtuar në faqet 41-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1- Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa që në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe të Mjedisit të mundësojë evidentimin dhe arkëtimin e detyrimeve

debitorë si dhe arkëtimin detyrime të tarifës vjetore nga 840 subjekte në shumën 8 522 000 lekë duke e evidentuar këto subjekte;

**Deri në 31.05.2024**

*Nga verifikimi rezultoi se, nga rakordimi i faturave të dorëzuara dhe të dhënave të dërguara nga Dega e Thesarit Tiranë (deri më datë 30.11.2024) AKM ka arkëtuar shumën prej 7,221,000 lekë detyrime të prapambetura dhe është në proces për evidentimin dhe arkëtimin e të gjitha detyrimeve të tarifave vjetore.*

**Në proces**

*Masa disiplinore*

*KLSH i ka rekomanduar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për 32 punonjës masa disiplinore, nga të cilat janë pranuar plotësisht të gjitha.*

### **C. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në nenin 59, pika 4, shkronja “a” dhe “b”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”.

I. I rekomandojmë **Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit** në vlerësim të parregullsive të konsideruara nga ana jonë, sipas pikës 1 shkronja “a” dhe “b” të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013, të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave disiplinore për personat përgjegjës të atakuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në proporcion me shkeljet e konstatuara sipas nenit 58, shkronja “b”, “c” dhe “ç” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil”, konkretisht:

1. N. P Drejtor i Drejtorisë së Kërkimit dhe Dijes Mjedisore,
2. B. T P/Spektori të Lejeve të Mjedisit,
3. E. M P/Spektori i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis,
4. J. M P/Spektori Juridik dhe Marrëdhënieve Ligjore
5. J. Ç (T), Specialiste në Sektorin të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.
6. E. Sh, Specialiste në Sektorin të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.
7. E. Z. Specialiste e Sektorit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.
8. O. Dh Specialist Sektorin të Lejeve Mjedisore,
9. E. K P/Spektorit të Monitorimit,
10. I. B, Inspektor në sektorin e Inspektimit mjedisor
11. A. G, Inspektor në sektorin e Inspektimit mjedisor,
12. H. B, Inspektor në Sektorin e Inspektimit mjedisor
13. P. M Inspektor në Sektorin e Inspektimit Mjedisor
14. O. T Inspektor në Sektorin e Inspektimit Mjedisor,
15. S. H Inspektor në Sektorin e Inspektimit Mjedisor
16. J. T Inspektor në Sektorin e Inspektimit Mjedisor,
17. A. C Inspektor në Sektorin e Inspektimit të Burimeve Ujore,
18. A. T Inspektor në Sektorin e Inspektimit të Burimeve Ujore,
19. A. S Inspektor në Sektorin e Inspektimit të Burimeve Ujore,
20. B. B Inspektor në Sektorin e Inspektimit të Burimeve Ujore,
21. B. P, për shkeljet trajtuar në Raportin Përfundimtar dhe konkretisht në procedurat e prokurimeve publike,
22. E. C, për shkeljet trajtuar në Raportin Përfundimtar dhe konkretisht në procedurat e prokurimeve publike,
23. Gj. F, 1 rast hartues dokumenteve të tenderit,
24. A. Q, 1 rast hartues dokumenteve të tenderit,
25. A. A, 1 rast hartues dokumenteve të tenderit,
26. K. T 1 rast hartues dokumenteve të tenderit, për shkeljet trajtuar në Raportin Përfundimtar dhe konkretisht në procedurat e prokurimeve publik,
27. I. H 1 rast Komisioni i Marrjes në Dorëzim,
28. K. A Përgjegjës Sektorin të Inspektimit Mjedisor;
29. K. B Përgjegjës Sektorin të Inspektimit të Burimeve Natyrore (Ujërave);
30. O. M Specialiste e Sektorit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis,
31. A. D P/Spektorit të Lejeve Mjedisore,
32. E. K P/Spektori i Monitorimit.

*Nga verifikimi rezultoi se, nuk janë marrë masa për zbatimin e këtij rekomandimi për 32 punonjësit*

**Zbatuar**

Me shkresën nr. 1476/2, datë 17.02.2025 është dërguar Projektraporti i auditimit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar në vitin 2023”.

Për sa është trajtuar në Projektraport nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 1476/3, datë 19.03.2025. ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

*Pretendimi i subjektit: Në observacionin e paraqitur pranohen detyrat e lëna dhe zbatimi i tyre brenda afatit të përcaktuar, ndërsa për përgjegjësitë sipas masave disiplinore të propozuara pasi janë shqyrtuar e analizuar në çdo drejtori është gjykuar që masat disiplinore të propozuara, konsiderohen të ezauruara.*

*Qëndrimi i Grupit të auditimit: Observacioni merret në konsideratë, kjo masë konsiderohet e zbatuar si dhe është pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit.*

### **Përmbledhëse e Masave:**

Lloji i Rekomandimit	Rekomandime gjithsej në numër	Pranuar	Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
Masa organizative	15	15	9	4		2
Masa për eliminimin e efektive negative	1	1			1	
Masa disiplinore	32	32	32			

### **III. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:**

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për Raportin e Auditimit “Për auditimin e përputhshmërisë” dërguar me nr. 562/19 prot., datë 28.12.2023, rezulton se subjekti i audituar **ka respektuar** afatin 20 ditor dhe ka hartuar plan masash për zbatimin e rekomandimeve, **ka njoftuar** brenda 6 muajve mbi ecurinë e zbatimit të këtyre masave, në përputhje me kërkesat e nenit 15 shkronja (j) dhe pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit,

Në përfundim të procesit të auditimit, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën e saj nr. 562/19, datë 28.12.2023, të pazbatuara ose të zbatuara pjesërisht, **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjore deri në mbylljen e plotë të tyre, si më poshtë:

**1.1- Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa që të planifikojë kryerjen e inspektimeve në subjekte të konstatuar me leje mjedisore model i vjetër për të mundësuar evidentimin e veprimtarisë ose jo dhe për rastet me shkelje t’i kërkojë Ministrin të Turizmit dhe të Mjedisit për pezullim apo shfuqizimin e lejeve mjedisore.

**Deri në 30.06.2025**

**2.1- Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe të Mjedisit të marrë masa që të kërkojë revokimin e lejeve mjedisore të miratuar pa dokumentacionin e kërkuar ligjor për subjektet: “N. 2010”; “E”; “A. A”; “B. T”; “V.A.L.E.R.”; “A”; “R. O”; “E. A”; “E. E”; “K.-F”; “P. X”; “A&C”.

**Deri në 30.06.2025**

**3.1- Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa që të planifikojë kryerjen e inspektimeve në subjekte: “B”, “A.S”, “G. E” dhe “G.-G”, për vlerësimin e raportit të ndikimit në mjedis.

**Deri në 30.06.2025**

Zbatimi i rekomandimeve për Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (Formulari nr. 12), në mënyrë tabelore paraqitet:

Nr	Lloji i Rekomandimit	Rekomandime Gjithsej në numër	Nga këto:				Nga rekomandimet gjithsej sa me dëme ekonomike ose efekt negativ në buxhet ose të ardhura të munguara								
			Pranuar në numër	Zbatuar në numër	Zbatuar pjesërisht në numër	Pa zbatuar në numër	Rekomanduar		Pranuar		Zbatuar/apo proces zbatimi		Ne Proces Civil apo Penal në 000/lek	Pa zbatuar filluar (Pa procedura)	
							Nr. pers	Në 000/lekë	Nr. pers.	Në 000/lekë	Nr. pers	Në 000/lekë		Nr. pers	Në 000/lekë
<b>I</b>	<b>NË FUSHËN E LEGJISLACIONIT</b>														
1	Shfuqizim akti														
2	Përmirësim akti														
<b>II</b>	<b>MASA ORGANIZATIVE</b> (Gjithsej, Në vlerë)	15	15	9	4	2									
<b>III</b>	<b>MASA SHPËRBLIM DËMI</b>														
	(Nga te cilat nuk janë kontabilizuar, ne Finance)														
<b>IV</b>	<b>MASA DISIPLINORE</b>	32	32	32											
	(Nga të cilat nuk janë nxjerrë urdhrat, vendime) me status të nëpunësit civil														
<b>V</b>	<b>MASA 3E</b>	1	1		1										
	Nga të cilat:														
	Të ardhura të munguara							8,522		8,522		7,221			
<b>VI</b>	Dhe të tjera masa nëse ka Gjaba APP														

**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**